

Standardi puro Serb me titull ***“Rregullore për homologimin”***.

Ky standard **103 faqësh**, specifikon kushtet e hollësishme për procedurën dhe metodën e homologimit për automjetet e prodhuara individualisht ose në seri (të plotë, të kompletuar, të modifikuar dhe jo të plotë), asambletë dhe pajisjet e automjeteve.

Në objektiv është harmonizimi i legjislacionit, në kuadër të rregullimit të fushës së homologimit të mjeteve motorrike.

Afati i fundit për marrjen e komenteve është **08-02-2020**.

Ky njoftim realizohet në kuadër të njoftimit të operatorëve ekonomikë që mund të kenë interesa tregtare me shtetin serb lidhur me këtë kategori produktesh, të cilët mund të

paraqesin komentet e tyre. Komentet potenciale adresohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, e cila me ligj është pika e kontaktit për sa i përket shkëmbimit të informacionit mbi standardet dhe rregullat teknike.